

Gjykata Speciale e hedh
poshtë kërkesën e
Shalës për modifikimin
e dënimit me burgim

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OEK-u I KËRKON BE-së T'I HEQË MASAT KUFIZUESE NDAJ KOSOVËS DHE TA HAPË RRUGËN PËR ZHVILLIM



Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, njëherësh edhe kryetar i Bordit Drejtues të Forumit të Investimeve të Odave të Ballkanit Perëndimor (WB6CIF), Lulzim Rafuna, i ka dërguar letër përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Çështjet e Jashtme, Kaja Kallas, duke shprehur shqetësimin e thellë për masat kufizuese që vazhdojnë të

aplikohen ndaj Kosovës. Në letrën e tij Rafuna thekson se këto masa janë duke penguar qasjen e institucioneve dhe bizneseve të Kosovës në instrumentet e BE-së për zhvillim ekonomik, duke pezulluar mbi 600 milionë euro projekte në fushat e mbrojtjes së mjedisit, energjisë, digjitalizimit dhe infrastrukturës lokale

AKTUALE



**ZELENSKY THOTË SE DONBASI
VAZHDON TË JETË PENGESË MES
TRYSNISË PËR NJË MARRËVESHJE
PËR PAQE F. 2**

**OSMANI UDHËTON PËR NË SELINË
E SHENJTË, DO TË PRITET NË
AUDIENCË NGA PAPA LEO XIV F. 5**

**ALI AHMETI PËRKRAH PROTESTËN
E OVLUÇ-SË NË SHKUP, BËN
THIRRJE PËR PJESËMARRJE F. 7**

EKONOMI



**PUNËTORËT E KEK-ut PROTESTOJNË
PËR RITJE PAGASH F. 8**

**IMRI DEMELEZI EMËROHET
MINISTËR NË DETYRË I BUJQËSISË F. 8**

SPORT



**FFK-ja I BASHKOHET INICIATIVËS
"FOOTBALL FOR THE GOALS" TË
OKB-së F. 11**

**DRINI GASHI,
KOSOVARI I PARË
QË I BASHKOHET
GARDËS KOMBËTARE
TË AJOVAS F. 3**



**KURTI:
MOSPAJTIMET
ME SHBA-NË,
GJITHMONË LIDHUR
ME SERBINË DHE
STRUKTURAT E SAJ F. 7**



RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk



NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇË



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SHA
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

ZELENSKY THOTË SE DONBASI VAZHDON TË JETË PENGESË MES TRYSNISË PËR NJË MARRËVESHJE PËR PAQE

KIEV, 12 DHJETOR - Kërkesat që Kievi t'i tërheqë trupat nga pjesa e Donbasit që ende e ka nën kontroll, vazhdon të jetë pengesë drejt përparimit në bisedimet për arritjen e një marrëveshjeje për paqe me Rusinë, tha presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky. Bisedimet për paqe po zhvillohen me shpejtësi dhe Shtetet e Bashkuara po ushtrojnë tryzni të madhe për një marrëveshje që do t'i jepte fund luftës pothuajse katërvjeçare të Rusisë kundër Ukrainës.

Statusi i centralit bërthamor të Zaporizhjas, i cili kontrollohet nga Rusia, është një çështje tjetër që duhet të zgjidhet, tha Zelensky për gazetarë mbrëmjen e së enjtes, pas bisedimeve të Ukrainës me mbështetësit evropianë dhe zyrtarët amerikanë.

Ai shtoi gjithashtu se një armëpushim do të ishte i nevojshëm, nëse zgjedhjet do të mbaheshin së shpejti.

Pasi Shtetet e Bashkuara e paraqitën një plan për paqe me 28 pika, i cili favorizonte dukshëm Rusinë sipas kritikëve, Ukraina dhe vendet evropiane po kërkojnë ndryshime që do ta bënin marrëveshjen më të



baraspeshuar dhe, mbi të gjitha, do ta siguronin mbrojtjen e Ukrainës ndaj ndonjë sulmi rus në të ardhmen.

Kievi ia dorëzoi ShBA-së një plan me 20 pika më herët gjatë kësaj jave. "Ne ia dërguam ekipit amerikan një version të rishikuar të dokumentit kornizë me të cilin punuam. Ai përfshin 20 pika kyçe. Ky mund të jetë themeli për gjithçka. Po pres përgjigje nga Amerika", tha Zelensky para më shumë se 30 udhëheqësve të vendeve të "koalicionit të vullnetit".

Derisa Rusia ka dhënë pak shenja se është e gatshme të heqë dorë nga kërkesat e kamotshme, zyrtarët amerikanë

dhe ata ukrainas po i shtjellojnë hollësitë.

Zelensky tha se kishte zhvilluar një diskutim "të thellë" me sekretarin amerikan të Shtetit, Marco Rubio, shefin e Mbrojtjes, Pete Hegseth, dhe të dërguarin e posaçëm të Shtëpisë së Bardhë, Steve Witkoff. Sipas Zelenskyt, ShBA-ja propozon tërheqjen e trupave ukrainase nga pjesa e fortifikuar e rajonit të Donjeckut të cilën e kontrollon ende, dhe "kompromisi është, teorikisht, që trupat ruse nuk do të hyjnë" në këtë zonë, ku Uashingtoni kërkon të vendosë një "zonë të lirë ekonomike".

"Ata nuk e dinë se kush do ta

qeverisë këtë territor", tha Zelensky, duke shtuar se Rusia e quan atë "zonë të demilitarizuar". Ai shtoi gjithashtu se ukrainasit duhet ta thonë fjalën e tyre për çdo lëshim territorial të propozuar, "qoftë përmes zgjedhjeve ose një referendumi".

Pas raportimeve se presidenti amerikan, Donald Trump, kishte vendosur datën 25 dhjetor si afatin që Ukraina ta pranonte propozimin e paqes, Zelensky tha se Kievi nuk i ishte dhënë ndonjë afat i prerë, por se "mendoj se ata me të vërtetë dëshironin, ose ndoshta ende duan, ta kuptojnë plotësisht deri në Krishtlindje se ku qëndrojmë me këtë marrëveshje".

Trumpi ka synuar ta ndërmyetësojë përfundimin e pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia qëkurse e mori detyrën në janar të këtij viti, por është përballur me pengesa të mëdha, duke përfshirë mospërfillje nga presidenti rus, Vladimir Putin, për armëpushim.

Trumpi tha se Shtetet e Bashkuara mund të marrin ose jo pjesë në një takim të planifikuar mes zyrtarëve të lartë ukrainas, francezë, gjermanë dhe britanikë në Evropë, më 13

dhjetor. "Do të shohim nëse do të marrim pjesë në takim", tha Trumpi para gazetarëve në Zyrën Ovale. "Do të marrim pjesë në takim të shtunën në Evropë, nëse mendojmë se ka shans të mirë. Dhe, nuk duam të humbasim shumë kohë, nëse mendojmë se është negativ", shtoi ai. "Presidenti është jashtëzakonisht i zemëruar me të dyja palët e kësaj lufte, dhe ai është i lodhur nga takimet vetëm sa për sy e faqe", u tha gazetarëve sekretarja për shtyp e Shtëpisë së Bardhë, Karoline Leavitt.

Lidhur me zgjedhjet, që ShBA-ja po e shtyn Ukrainën t'i mbajë pavarësisht faktit se ato janë të ndaluara me ligjin ushtarak, Zelensky tha më 11 dhjetor se nevojitet armëpushim për këtë. Trumpi i tha "Politicos" në një intervistë të botuar më 9 dhjetor se "është koha" të mbahen zgjedhjet, dhe Zelensky tha po atë ditë - për herë të parë - se do të kërkonte nga Parlamenti të hartonte legjislacion që lejon mbajtjen e zgjedhjeve gjatë ligjit ushtarak. Ai tha se zgjedhjet mund të mbahen brenda 60 deri në 90 ditëve, me kusht që të ketë garanci të sigurisë për të siguruar që votimi të jetë i sigurt për ukrainasit.

KLODIAN BRAHO ZGJIDHET KREU I RI I SPAK-ut

TIRANË, 12 DHJETOR - Klodian Braho do të udhëheqë Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar në Shqipëri (SPAK), pasi mori shtatë vota nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, raportojnë mediet në Shqipëri. Ai do ta marrë drejtimin e SPAK-ut pasi kreut aktual, Altin Dumani, t'i përfundojë mandati.

Braho ka përvojë 18-vjeçare në sistemin e drejtësisë dhe është pjesë e SPAK-ut që nga themelimi i këtij institucioni në dhjetor të vitit 2019.

Mediet në Shqipëri raportojnë se Braho para Këshillit të Lartë të Prokurorisë prezantoi arritjet e tij, duke përmendur edhe konfiskimin e 18.4 milionë eurove të krimit më 2023. Ai deklaroi se synon ta forcojë SPAK-un duke themeluar një sektor të posaçëm për analizën e informacionit. Gjatë prezantimit Braho tha se lufta kundër korrupsionit dhe garantimi i barazisë para ligjit ishin prioritetet kryesore të kandidimit të tij, teksa theksoi se është e rëndësishme që të mbështetet pavarësia e prokurorëve.

Për kreun e SPAK-ut ishin katër kandidatë që prezantuan platformën e tyre para Këshillit të Lartë. Në këtë seance ishte e



pranishme edhe e ngarkuara me punë e ShBA në Tiranë, Nancy VanHorn, ambasadori i BE-së, Silvio Gonzato, dhe ambasadori britanik, Nicholas Abbott.

Braho do të jetë udhëheqësi i tretë i SPAK-ut. Kryetari i parë ishte Arben Kraja dhe më pas e mori drejtimin Altin Dumani. Braho ka mandat trevjeçar në krye të SPAK-ut dhe nuk ka të drejtë të rizgjedhjes.

Një ditë para zgjedhjes së kreut të ri, zëvendës drejtori për Çështje të Evropës Qendrore dhe Lindore i ShBA-së, Lyn Bebevoise, vizitoi SPAK-un dhe shprehu mirënjohje për punën e Dumanit me autoritetet amerikane për t'i luftuar rrjetet e paligjshme "që kërcënojnë

sigurinë e ShBA-së dhe luftën kundër korrupsionit, i cili dëmton kompanitë dhe investitorët amerikanë".

"Përpjekjet e zotit Dumani vendosin standardin për një bashkëpunim të fortë ShBA - Shqipëri kundër organizatave kriminale transnacionale, që shpresojmë se do të vazhdojë edhe pasardhësi i tij", u tha në njoftim.

Karriera e Brahos

Braho, 43-vjeçar, ka përfunduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë më 2004 dhe më 2008 në Shkollën e Magistraturës. Ka qenë prokuror në Prokurorinë e Beratit dhe më pas në atë të



Vlorës ku ishte pjesë e njësisë Task-Forcë dhe për dy vjet e drejtoi atë. Ai ishte edhe zëvendës drejtues i kësaj prokurorie.

Nga viti 2016 deri më 2019 punoi në Prokurorinë e Krimeve të Rënda si pjesë e Njesisë për Hetimin e Korrupsionit dhe Pasurisë, me kompetencë për t'i hetuar zyrtarët e lartë shtetërorë dhe zyrtarët e drejtësisë.

Ndërkaq, që nga dita e themelimit të SPAK-ut ai është pjesë e saj. Nga prilli i vitit 2023 Braho mbajti detyrën e drejtuesit të seksionit kundër korrupsionit në SPAK.

SPAK-u është krijuar në dhjetor të vitit 2019, pas ndryshimeve kushtetuese që u votuan më

2016. Kjo strukturë ka hetuar disa ish-zyrtarë, ish-ministra e deputetë, të cilët janë duke e vuajtur dënimin.

Ky organ ka kryer hetime kundër korrupsionit ndaj figurave të larta, sikurse ish-presidenti Ilir Meta dhe ish-kryeministri Sali Berisha. Berisha është liruar nga arresti shtëpiak në fund të nëntorit të vitit të kaluar, ndërkaq Meta gjendet në paraburgim. Së voni, struktura kundër korrupsionit ka ngritur aktakuzë ndaj zëvendëskryeminstres të Shqipërisë, njëherësh ministre e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku. Ajo është pezulluar nga detyrat shtetërore dhe i është ndaluar largimi nga Shqipëria.

DRINI GASHI, KOSOVARI I PARË QË I BASHKOHET GARDËS KOMBËTARE TË AJOVAS



PRISHTINË, 12 DHJETOR - Duke shënuar një moment historik në partneritetin e Gardës Kombëtare të Ajovës (Iowa) me Kosovën, aviatori Drini Gashi, shtetas i Kosovës, ngriti dorën e djathtë dhe iu bashkua kësaj garde në bazën 132d Air Wing më 20 nëntor.

Drini është personi i parë nga Kosova që është partneri shtetëror i Gardës Kombëtare të Ajovës në kuadër të Programit të Partneritetit Shtetëror (SPP, që i bashkohet GKA-së. Ai u betua nga gjeneralmajori në pension, Timothy Orr, ish-Adjutant i Përgjithshëm i Gardës Kombëtare të Ajovës, i cili kishte avokuar që Ajova të bëhej pjesë e programit. Garda Kombëtare e Ajovës dhe Kosova janë partnerë të SPP-së që nga viti 2011, raporton “dvidshub”. “Angazhimi i

Drinit shënon edhe një tjetër pikë kthese në marrëdhënien që forcon lidhjen mes Ajovës dhe Kosovës”, tha Orr. “Ne shërbejmë së bashku, punojmë së bashku dhe luftojmë së bashku”. Motivimi i Drinit për të shërbyer lidhet me vitin 2012, kur ai u shpërngul nga Kosova në Washington, D.C. Babai i tij, gjeneral brigade në pension i FSK-së, Xhavit Gashi, shërbeu si atashe i FSK-së në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Ajova. Gjatë asaj kohe, Xhavit Gashi u takua me Orrin dhe të dy ndërtuan një miqësi të përjetshme në vitet e hershme të partneritetit të Gardës Kombëtare të Ajovës me Kosovën.

Familja Gashi u shpërngul në Ajova në vitin 2016, kur Xhavit mori pozitën e konsullit të përgjithshëm në Konsullatën e

Republikës së Kosovës në Des Moines, Ajova. Gjatë asaj kohe familja Gashi jetoi në Camp Dodge. Pikërisht aty Drini pati ndërveprimet e para me pjesëtarët e Gardës Kombëtare të Ajovës. “Më pëlqeu shumë jeta atje”, tha Drini. “Më pëlqente t’i shihja nga afër pjesëtarët e Gardës Kombëtare të Ajovës”.

Pas disa vitesh në Ajova, familja Gashi u kthye në Kosovë. Megjithatë Drini vazhdoi të ndiente një lidhje të fortë me Ajovën dhe vendosi të kthehej për ta ndjekur kolegjin. Së shpejti, ai nisi rrugëtimin drejt shtetësisë amerikane duke u regjistruar në Gardën Kombëtare të Ajovës përmes Programit të Sponsorizimit dhe Shtetësisë së Përsheptuar. “E dua këtë vend dhe e dua atë që ky vend përfaqëson”, tha Drini. “Ajo që

është ky vend, është më e madhja në botë”. Drejtorët e kaluar dhe aktualë të Programit të Partneritetit Shtetëror ishin të pranishëm në ceremoninë e betimit, ku u shpreh një ndjenjë e përbashkët krenarie për angazhimin e Drinit. “Qëllimi i Programit të Partneritetit Shtetëror është të ndërtojë marrëdhënie mes Gardës Kombëtare të ShBA-së dhe ushtrive e qeverive të huaja, duke nxitur bashkëpunimin në siguri, përmirësimin e ndërveprimit dhe mbështetjen e interesave kombëtare të ShBA-së”, tha nënkoloneli Joel Jacobson, ish-drejtor i Programit të Partneritetit Shtetëror. “Ajova e ka arritur këtë përmes qindra shkëmbimeve ushtarake mes Ajovës dhe Kosovës, por tani Ajova ka një kosovar të

regjistruar në radhët e saj. Kjo është një arritje e madhe dhe i shton talent Gardës Kombëtare të Ajovës”.

Angazhimi i Drinit hap rrugën që edhe kosovarë të tjerë t’i bashkohen Gardës Kombëtare të Ajovës si pjesë e forcimit të vazhdueshëm të marrëdhënieve Ajova-Kosovë. “Shpresojmë që ky moment monumental të krijojë një precedent që kosovarët t’i bashkohen Gardës Kombëtare të Ajovës dhe të bëhen qytetarë të ShBA-së”, tha nënkoloneli në pension Kerri Lewers, drejtoreshë e Programit të Partneritetit Shtetëror. “Edhe pse Ajova nuk ka një komunitet të madh kosovar, miqësitë dhe marrëdhëniet unike të krijuara mes Gardës Kombëtare të Ajovës dhe FSK-së janë ndërtuar mbi besim dhe janë si familje”.

GJYKATA SPECIALE E HEDH POSHTË KËRKESËN E SHALËS PËR MODIFIKIMIN E DËNIMIT ME BURGIM

HAGË, 12 DHJETOR - Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë e kanë hedhur poshtë kërkesën e ish-eprorit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Haxhi Shala, për modifikimin apo uljen e dënimit me tri vjet burgim.

Në një njoftim për medie, gjykata e Kosovës në qytetin holandez, e njohur edhe si Gjykata Speciale, tha se kryetarja e saj, Ekaterina Trendafilova, vendosi më 11 dhjetor se dënimi i Haxhi Shalës nuk do të ulet apo të modifikohet pas vuajtjes së dy të tretave të dënimit të tij.

Shala u dënua me tre vjet burgim në shkurt të këtij viti, si dhe me gjobë prej 400 eurosh, pasi paraprakisht e kishte pranuar fajësinë për pengim të drejtësisë.

Atij iu mohua modifikimi apo ulja e dënimit pasi Trendafilova,

pas konsultimit me gjykatësit e paneleve që kishin shqiptuar dënimin, erdhi në përfundim se Shala “nuk kishte shprehur keqardhje” për krimin.

Trendafilova do ta shqyrtojë modifikimin e mundshëm të dënimit të Shalës në shkurt, sipas njoftimit.

Shala është mbajtur në burgun e qytetit holandez nga 11 dhjetori 2023, që nënkupton se atij i ka mbetur vetëm edhe një vit nga vuajtja e plotë e dënimit prej tri vjetësh.

Shala ishte dënuar së bashku me dy të tjerë, Sabit Januzin dhe Ismet Bahtijarin, ndaj të cilëve prokurorët e Gjykatës Speciale kishin aktakuzë për pengim të drejtësisë.

Bahtijari dhe Januzi u dënuan me nga dy vjet burgim.

Që të tre kishin arritur marrëveshje me prokurorët për pranimin e fajësisë.





OEK-u I KËRKON BE-së T'I HEQË MASAT KUFIZUESE NDAJ KOSOVËS DHE TA HAPË RRUGËN PËR ZHVILLIM

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, njëherësh edhe kryetar i Bordit Drejtues të Forumit të Investimeve të Odave të Ballkanit Perëndimor (WB6CIF), Lulzim Rafuna, i ka dërguar letër përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Çështjet e Jashtme, Kaja Kallas, duke shprehur shqetësimin e thellë për masat kufizuese që vazhdojnë të aplikohen ndaj Kosovës. Në letrën e tij Rafuna thekson se këto masa janë duke penguar qasjen e institucioneve dhe bizneseve të Kosovës në instrumentet e BE-së për zhvillim ekonomik, duke pezulluar mbi 600 milionë euro projekte në fushat e mbrojtjes së mjedisit, energjisë, digjitalizimit dhe infrastrukturës lokale

fushat e mbrojtjes së mjedisit, energjisë, digjitalizimit dhe infrastrukturës lokale. Oda Ekonomike e Kosovës kërkon heqjen e këtyre masave për të mundur qasje të barabartë në instrumentet rajonale dhe për të garantuar që sektori privat i Kosovës të kontribuojë në të ardhmen evropiane të përbashkët. OEK dhe WB6CIF mbeten të gatshme për bashkëpunim të vazhdueshëm me institucionet e BE-së dhe partnerët rajonalë për të avancuar një Ballkan Perëndimor të qëndrueshëm, të integruar dhe perspektivëdhënës. Edhe presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, më 9 dhjetor ka pritur në takim raportuesin për Kosovën në Parlamentin Evropian, Riho Terras. Në takim u diskutua edhe për masat e vendosura të BE-së. Presidentja Osmani theksoi se, pavarësisht prej bashkëpunimit konstruktiv, vazhdimi i masave të BE-së

ndaj Kosovës mbetet i pashpjegueshëm, i padrejtë dhe i paarsyeshëm. Në këtë kontekst, Osmani kërko mbështetjen e Terras për heqjen sa më të shpejtë të këtyre masave, duke rikujtuar se ato dëmtojnë qytetarët dhe minojnë besimin në procesin e integritetit, teksa Kosova ka përmbushur çdo kërkesë të paraqitur nga partnerët evropianë. Sipas presidentes Osmani, heqja e masave do të ishte një sinjal i fuqishëm për qytetarët dhe një mesazh inkurajues për vazhdimin e reformave. Më tej, Osmani shtoi nevojën që kërkesa e Kosovës për anëtarësim në BE të procedohet sa më parë dhe që anëtarësimi të bëhet në bazë të meritave. Gjatë takimit presidentja paraqiti një sërë të dhënash të institucioneve ndërkombëtare që e pozicionojnë Kosovën në majat e performancës në shumë fusha kyçe. BE-ja i vendosi disa masa ndëshkuese Kosovës më 2023

për shkak të rritjes së tensioneve në veriun e vendit të banuar me shumicë serbe. Në maj të këtij viti, shefja e diplomacisë së BE-së, Kaja Kallas, gjatë një vizite në Kosovë tha se blloku ka nisur heqjen graduale të këtyre masave. Po ashtu, edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Bedri Hamza, ia ka dërguar një letër zyrtare presidentes së Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ku kërkon heqjen e menjëhershme dhe të pakushtëzuar të masave të BE-së ndaj Kosovës. Në tekstin e letrës bie në sy një qasje që shkon përtej interesit partiak dhe zgjedhor, duke e vendosur perspektivën evropiane të Kosovës mbi çdo rivalitet politik. Në qendër të mesazhit të tij, Hamza thekson se Kosova duhet trajtuar si çdo vend tjetër i Ballkanit Perëndimor, duke theksuar se sanksionet po e dëmtojnë vendin në momente kyçe për integrimin

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, në cilësinë e tij edhe si kryetar i Bordit Drejtues të Forumit të Investimeve të Odave të Ballkanit Perëndimor (WB6CIF), i ka dërguar një letër Kaja Kallas, përfaqësuese e Lartë e Bashkimit Evropian

për Çështjet e Jashtme, duke shprehur shqetësimin e thellë për masat kufizuese që vazhdojnë të aplikohen ndaj Kosovës. Në letrën e tij, kryetari Rafuna thekson se këto masa pengojnë qasjen e institucioneve dhe bizneseve të Kosovës në instrumentet e BE-së për zhvillim ekonomik, duke pezulluar mbi 600 milionë euro projekte në

Osmani udhëton për në Selinë e Shenjtë, do të pritët në audiencë nga Papa Leo XIV

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, ka udhëtuar për në Selinë e Shenjtë, ku do të zhvillojë një sërë takimesh. Presidentja Osmani, së bashku me Zotërinë e Parë, Prindon Sadriu, do të priten në audiencë nga Papa Leo XIV në Pallatin Apostolik.

Po ashtu, presidentja do të zhvillojë takim me sekretarin e Shtetit të Vatikanit, kardinalin Pietro Parolin. Gjatë vizitës në Vatikan, presidentja Osmani do ta vizitojë edhe Bazilikën e Shën Pjetrit. Në selinë e Misionit të Posaçëm të Republikës së Kosovës në Selinë e Shenjtë, Osmani do të organizojë një

pritje të fundvitit me përfaqësues të Selisë së Shenjtë, përfaqësues diplomatik dhe personalitete të tjera. Gjatë kësaj vizite ajo do të realizojë edhe një sërë aktiviteteve të tjera me qëllim të thellimit të raporteve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Selisë së Shenjtë.



POLICIA E KOSOVËS DHE CEPOL FORCOJNË PARTNERITETIN PROFESIONAL

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Policia e Kosovës dhe CEPOL kanë avancuar bashkëpunimin profesional përmes një aktiviteti të rëndësishëm të zhvilluar ditë më parë në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike. Projekti i CEPOL-it, i fokusuar në hetimin e narkotikëve, ka kontribuar ndjeshëm në ngritjen e kapaciteteve hetimore dhe operative të Policisë së Kosovës. Gjatë aktivitetit, CEPOL i ndau Policisë së Kosovës mirënjohje për bashkëpunim të shkëlqyeshëm dhe partneritet të qëndrueshëm. Policia e Kosovës shprehu falënderim për mbështetjen e vazhdueshme të CEPOL-it dhe institucioneve partnere që kontribuojnë në forcimin e sigurisë publike. Ky partneritet konfirmon përkushtimin e ndërsjellë për integrimin e standardeve evropiane dhe zhvillimin e kapaciteteve moderne të zbatimit të ligjit në vend.



Licencohen profesionistë, ofrues të shërbimeve sociale dhe familjare

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Ushtuesi i detyrës i ministrit të Drejtësisë, Blerim Sallahu, ka ndarë të premten certifikatat mbi licencimin e gjashtë profesionistëve që merren me shërbime sociale dhe familjare, duke përfunduar më tej angazhimin për ofrimin e

shërbimeve të specializuara dhe cilësore për individët dhe familjet në nevojë. Ministri Sallahu tha se ky licencim është një dëshmi e angazhimit të vazhdueshëm të Ministrisë së Drejtësisë për të siguruar mbështetje të plotë dhe profesionale për ata që

kanë nevojë për ndihmë. Profesionistët e licencuar do të kenë mundësinë të ofrojnë mbështetje për individët dhe familjet duke garantuar që ata të kenë qasje në shërbime cilësore, të sigurta dhe të mbështetura nga standardet ligjore dhe profesionale.



evropian dhe euroatlantik. “Vendit tonë duhet t’i jepen të njëjtat mundësi, mjete dhe mbështetje si të gjitha vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor në rrugën e tyre drejt BE-së dhe NATO-s”, shkruan ai. Duke reflektuar mbi vitin sfidues që ka kaluar Kosova, me tri procese zgjedhore brenda një viti, Hamza shpjegon se këto janë dëshmi të “qëndrueshmërisë dhe pjekurisë së demokracisë së Kosovës”. Ai thotë se proceset zgjedhore janë zhvilluar “demokratikisht, me transparencë dhe paqësisht”, pavarësisht bllokadës së mëvonshme politike.

Në letërën e tij, Hamza risjell në vëmendje sakrificat dhe obligimet që Kosova ka marrë përsipër në rrugën e integritetit, përfshirë edhe krijimin e Dhomave të Specializuara. Ai e quan këtë një kërkesë të imponuar vetëm mbi Kosovën, e cila “fatkeqësisht është shndërruar në një instrument monoetnik”. Por, pjesa më shprehëse e letërës është thirrja e tij për unitet dhe qasje të përbashkët shtetërore ndaj interesave strategjike. “Pavarësisht se kush do t’i udhëheqë institucionet e Kosovës pas zgjedhjeve, vendi ynë duhet të ketë të njëjtat mjete dhe

mbështetje si të gjitha të tjerat në rajon. Vazhdimi i masave e privon Kosovën nga këto mundësi dhe rrezikon të minojë vlerat demokratike dhe pro-evropiane”. Kjo fjalë e përmbledh filozofinë e letërës: çështja e sanksioneve nuk është e një qeverie apo partie, por e vet shtetit të Kosovës. Në përmbyllje, Hamza i bën thirrje BE-së të dërgojë një sinjal të fortë mbështetjeje ndaj qytetarëve të Kosovës, duke kërkuar vendimin që do t’i hapte rrugë një faze të re të marrëdhënieve. “Kërkoj me respekt heqjen e menjëhershme dhe të

pakushtëzuar të të gjitha masave të BE-së ndaj Kosovës”. Letra reflekton një pozicion që Hamza e paraqet jo vetëm si lider partie, por edhe si një figurë burrështetasi që synon stabilitet, partneritet dhe trajtim të drejtë të Kosovës në proceset euroatlantike. Bashkimi Evropian (BE) vendosi masa ndëshkuese ndaj Kosovës në verën e vitit 2023 si pasojë e tensioneve në veriun e banuar me shumicë serbe, ato u përshkruan si të përkohshme, ndërsa kushtet për heqjen e tyre qenë të qarta. Zyrtarët në Kosovë ngulmojnë se kërkesat e BE-së për

largimin e masave që e dëmtuan vendin në vlera milionëshe janë plotësuar: situata në veri është shtensionuar, prania e policisë afër objekteve komunale në veri është zvogëluar, serbët kanë marrë pjesë në zgjedhjet e mbajtura sivjet dhe kalimi paqësor i pushtetit në komunat me shumicë serbe është realizuar. Por, ditët e fundit u raportua në mediet e Kosovës, bazuar në burime brenda BE-së, se vende si Franca dhe Italia, të mbështetura nga Spanja, Hungaria dhe Sllovakia, nuk kanë vullnet për heqjen e sanksioneve.

Nagavci viziton Universitetin e Gjakovës dhe të Prizrenit, takohet me studentët përfitues të bursave elitare dhe STEM

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Ministrija në detyrë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, Arbërie Nagavci, ka vizituar Universitetin “Fehmi Agani” në Gjakovë dhe Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, ku ka takuar studentët përfitues të bursave elitare dhe atyre STEM. Gjatë takimit me studentët në Gjakovë, ministrija Nagavci theksoi se bursat përfaqësojnë një mundësi të rëndësishme për t’i vlerësuar arritjet, ambiciet dhe ëndrrat e gjeneratës së re, duke i inkurajuar të vazhdojnë të

investojnë në dijen dhe zhvillimin profesional. Rektor i Universitetit të Gjakovës, Drilon Bunjaku, falënderoi ministren për mbështetjen e vazhdueshme ndaj institucionit dhe studentëve. Vetëm këtë vit 126 studentë të këtij universiteti janë përfitues të bursës elitare, prej tyre 117 vajza dhe 9 djem - një dëshmi e qartë e talentit, punës dhe përkushtimit të tyre. Ndërsa në Universitetin e Prizrenit, ministrija Nagavci u

prit nga rektori Mentor Alishani, i cili vlerësoi bashkëpunimin e shkëlqyer me MASHTI-n dhe theksoi se rezultatet e studentëve janë tregues i punës së mirë që po bëhet në universitet. Ministrija Nagavci, në fjalën e saj, shprehu mirënjohje për punën e universitetit dhe përkushtimin e stafit akademik, duke theksuar se Prizreni po dëshmon rritje të qëndrueshme në cilësi dhe performancë të studentëve. Nga Universiteti i Prizrenit, gjatë këtij viti akademik, 150 studentë



janë përfitues të bursave elitare, ndërsa 50 të tjerë kanë përfituar bursat STEM, duke reflektuar rritjen e interesimit dhe performancës së lartë në programet shkencore dhe teknologjike. MASHTI vazhdon t’i mbështesë

studentët ekselentë dhe talentet e rinj përmes skemave të ndryshme të bursave, me qëllim të stimulimit të cilësisë në arsim, avancimit akademik dhe krijimit të mundësive të barabarta në të gjitha universitetet publike të vendit.

LIDERE ORGANIKE E PDK-së



Ismail SYLA

Kjo foto e sotme me znj. Vlora Çitaku në korridorin e zyrave të Partisë Demokratike të Kosovës në këtë ditë dhjetori më zgjoi shumë kujtime dhe histori. Ajo, një vajzë e re, që nga shkolla e mesme kryeqytetëse, ishte e angazhuar me ekupe të gazetarëve të huaj, që po raportonin për zhvillimet dramatike dhe tragjike anembanë Kosovës. Bijë e dy prindërve, profesorëve

universitarë, e piktorit akademik Shaip Çitaku dhe profesoreshës Sala Ahmeti, (që në vitet 1979-1981 pata fatin të jem student i saj në katedrën e Letërsisë dhe gjuhës shqipe) Vlora e kishte të ngjizur dashurinë ndaj atdheut, edhe duke qenë mbesë Radisheve, e vendlindjes së Shotë Galicës, e cila ke qenë dhe mbetet simbol i gruas luftëtare. Për Vlorën tepër të re njohja me vlerat, fuqinë dhe konceptin

politik të organizatës politiko-ushtarake të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishte përvojë goxha e vjetër. Ajo që më kohë ishte mishëruar si pjesë e filozofisë politike të një brezi që po hynte në skenën e madhe politike të Kosovës së çliruar. Nëse kërkon një person të gjeneratës së saj që ka lidhje organike dhe është vetë organika e Partisë Demokratike të Kosovës, atë nuk mund ta gjesht dot. Ajo edhe studimet universitare i mbaroi pa u shkëputur asnjë ditë nga fryma e zhvillimit dhe rritjes së PDK-së. Në platformën e këtij korridori ka ecur historia, kanë lëvizur figura me peshë të madhe politike të PDK-së. Vlora, si muret dhe zyrtat është dëshmitare e zhvillimit të politikave të PDK-së në të gjitha fazat. Në fazat e rrugës në konsolidim e sipër, në fushata zgjedhore, lokale e parlamentare, në fazat e fitoreve dhe të humbjeve të zgjedhjeve, e qëndrimit në bashkëqeverisje, e rënies në opozitë, por edhe të fitores historike më 17 nëntor 2007. Në të gjitha këto ngritje e rënie, Vlora është shembull i qëndrueshmërisë dhe besnikërisë së shtëpisë së saj

politike. Si zëdhënëse e PDK-së, Vlora e ushtroi këtë pozitë me sharm dhe shije, dhe si figurë e re me botëkuptim të përparuar, ajo u bë simbol i fytyrës së veprimtares politike që zë vend në një parti politike, e cila edhe në opozitë kishte ndikim madhor përballë zhvillimeve në Kosovën ende të pashpallur si shtet i pavarur. Në procesin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, përmbjlljes kulminante të të një aspirate kombëtare, në kohën kur PDK-doli forca e parë si në zgjedhjet lokale, ashtu edhe nacionale, Vlora Çitaku së bashku me z. Bekim Çollaku ishte pjesë aktive e ekipit politik të kryesuar nga kryeministri Hashim Thaçi që parapërgatiti aktin e shpalljes së pavarësisë më 17 shkurt 2008. Duke qenë ADN e përbrendësuar e PDK-së, Vlora Çitaku ishte krejt e natyrshme të bëhet deputete në Kuvendin e Kosovës, pastaj ministre e integriteteve evropiane, shefe e misionit diplomatik të Republikës së Kosovës në Nju Jork dhe ambasadore në Uashington. Pas përfundimit të misionit në Uashington, edhe si rezultat i ndryshimeve politike në nivel vendi, Vlora Çitaku, sot është

njëra nga liderët më të rëndësishme të Partisë Demokratike. Si funksionare e lartë e PDK-së me profilin e pasur të politik ajo është duke luajtur rol aktiv të rëndësishëm që reflekton filozofinë e frymës unifikuese, ekuilibruese në PDK, e cila si parti e madhe dhe historike, ka një udhë përshkuese jo pa sprova dhe pa sfida të rënda. Në kohën kur dy liderët e PDK-së, Hashim Thaçi dhe Kadri Veseli ende ballafaqohen në Hagë me padrejtësinë e Gjykatës Speciale, PDK-së më shumë se gjithçka tjetër i duhen në krye të saj quadro e liderë të profilin politik të Vlora Çitakut: të qëndrueshëm, besnikë, të moderuar, të emancipuar, pajtues, por edhe rigorozë në përfaqësimin e filozofisë politike të partisë dhe reflektimin e shëndetshëm në mbarë skenën politike të Kosovës. Partia Demokratike e Kosovës aktualisht dhe gjithmonë është me fat që pat, ka dhe do të ketë liderë më integritet të tillë, siç është Vlora Çitaku dhe siç është kryetari aktual i sapozgjedhur, z. Bedri Hamza, kandidati më potencial për kryeministër të Kosovës, pas 28 dhjetorit të sivjetmë. Suksese të pareshtura Vlorë!

Betohet kryetari i ri i komunës së Mitrovicës, Faton Peci

MITROVICË, 12 DHJETOR - Në Qendrën e Kulturës “Rexhep Mitrovica” të premten është mbajtur mbledhja inauguruese, në të cilën Faton Peci dha betimin dhe mori zyrtarisht detyrën e kryetarit të komunës së Mitrovicës. Mbledhjen e udhëhoqi anëtar i më i vjetër i Kuvendit, Naser Muja, nga radhët e Lëvizja Vetëvendosje. Në këtë seancë u bë betimi solemn i 30

anëtarëve të Kuvendit, të zgjedhur në zgjedhjet lokale të mbajtura më 12 tetor 2025. Para anëtarëve të Kuvendit betimin e ka bërë edhe kryetari i komunës së Mitrovicës, Faton Peci, i cili mori mandatin për ta udhëhequr komunën për katër vitet e ardhshme. Në fjalimin e tij pas betimit, kryetari i komunës, Faton Peci, potencoi se është mirënjohës

për besimin që i është dhënë përgjegjësisë më e madhe që njeriu mund ta marrë nga qyteti i tij. “Mitrovica, ky qytet i historisë, krenarisë, rezistencës, vuajtjes, durimit e mosdorëzimit dhe ku çdo kalldrëm është i larë me gjak, këtë vit ka bërë për mua maksimumin e mundshëm, prandaj përgjegjësisë për mua është tepër e lartë. Nga sot dera ime është e hapur për

secilin pa dallim me apo pa protokoll”, është shprehur kryetari Peci. Në përmbjllje të fjalimit, Peci ka shtuar se do të punojë me ndershmëri, me zemër, me durim dhe me drejtësi. “Na duhet dashni për qytetin. Na duhet kujdes. Na duhet përkushtim. Mitrovica është jo vetëm qyteti ynë, por është edhe zemra e Kosovës”, ka thënë ai.



Pas betimit është bërë dorëzim pranimi i detyrës, me ç’rast Faton Peci zyrtarisht ka pranuar detyrën e kryetarit të komunës së Mitrovicës nga ish-kryetari Bedri Hamza.

KURTI: MOSPAJTIMET ME SHBA-në, GJITHMONË LIDHUR ME SERBINË DHE STRUKTURAT E SAJ

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë të enjten se marrëdhëniet e vendit me Shtetet e Bashkuara janë shumë të mira dhe që mospajtimet kryesore kanë pasur të bëjnë gjithmonë lidhur me Serbinë dhe strukturat e saj, dhe asnjëherë për çështje bilaterale. “Kur Shtetet e Bashkuara kanë kërkuar nga ne që t’i pranojmë refugjatët nga Afganistani menjëherë kemi thënë ‘po’, e kemi hequr taksën 10 për qind, po ashtu po i pranojmë edhe ata të cilët Shtetet e Bashkuara nuk i duan në territorin e tyre, nëse nuk gabojnë një ose dy prej tyre tani janë këtu, kemi pranuar t’i pranojmë 50”, ka thënë Kurti në një intervistë dhënë televizionit lokal në Kosovë, Kanal 10.

“Radio Evropa e Lirë” ka kërkuar më shumë hollësi nga Zyra e Kryeministrit për personat që mund të kenë arritur në Kosovë në kuadër të marrëveshjes me ShBA-në dhe është në pritje të përgjigjes.

Duke folur më tej për mospajtimet eventuale me ShBA-në, Kurti ka thënë se ka pasur raste kur Shtetet e Bashkuara kanë konsideruar që qëndrimi i tij karshi Serbisë ka qenë shumë rigoroz. “Por, unë nuk mund të pres nga ShBA-ja që ta ketë qëndrimin për Serbinë si e ka Kosova. ShBA-ja e ka njohur Serbinë, e ka njohur edhe Kosovën, janë miq e aleatë tanë. Madje janë aleati i pazëvendësueshëm dhe partneri kyç yni. Janë edhe miku ynë special”, tha ai.

I pyetur nëse do të mund të shmangej pezullimi i dialogut strategjik mes ShBA-së dhe Kosovës, Kurti ka insistuar se marrëdhëniet mes dy palëve janë shumë të mira dhe janë të shtrira në tri dimensione: zhvillim, diplomaci dhe mbrojtje. “Kurrë nuk kanë qenë, sa i përket mbrojtjes dhe sigurisë, marrëdhëniet më të mira sesa tani me Shtetet e



Bashkuara të Amerikës. E kemi kulmin. Si shtet i pavarur e kemi kulmin sa i përket mbrojtjes dhe sigurisë”, ka deklaruar ai.

“Radio Evropa e Lirë” ka kërkuar një koment nga Ambasada Amerikane në Prishtinë lidhur me deklaratimet e Kurtit dhe është në pritje të përgjigjes.

Në shtator të këtij viti, ShBA-ja ka bërë me dije se ka pezulluar për një kohë të pacaktuar dialogun e planifikuar strategjik me Kosovën për shkak të shqetësimeve lidhur me veprimet e qeverisë në detyrë.

Dialogu ishte planifikuar për t’i forcuar lidhjet ekonomike dhe diplomatike, por veprimet e Kurtit janë parë si sfida për përparim.

Disa analistë politikë patën komentuar atë kohë se pezullimi ishte paralajmërim se mbështetja ndërkombëtare për Kurtin dhe qeverinë e tij po

zbehet.

Vitet e fundit Kurti ka qenë disa herë në shënjestër të kritikave nga aleatët ndërkombëtarë për shkak të disa vendimeve në veri të Kosovës - zonë e banuar me shumicë serbe - që lidheshin me zëvendësimin e targave serbe me ato të Kosovës, heqjen e dinarit serb nga përdorimi apo mbylljen e institucioneve serbe.

Kurti i ka justifikuar këto veprime si hapa drejt shtrirjes së sundimit të ligjit në veri dhe ka thënë se ato janë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës. Por, bashkësia ndërkombëtare, në disa raste, i ka cilësuar të njëanshme dhe të pakoordinuara me aleatët.

Për dialogun strategjik

Dialogu strategjik është një proces që Departamenti Amerikan i Shtetit në shumicën e rasteve zhvillon

me vende të ndryshme të botës me synim avancimin e marrëdhënieve bilaterale.

Ky proces përfshin diskutime të nivelit të lartë mes dy vendeve që zhvillohen ose në Uashington, ose në vendin përkatës, mbi një gamë të gjerë temash si mbrojtja, siguria, mjedisi, energjia, bashkëpunimi ekonomik etj. Shtetet e Bashkuara i kanë ndarë mbi dy miliardë dollarë për Kosovën prej vitit 1998. Udhëheqës shtetërorë të Kosovës e kanë përsëritur ndër vite që Amerika është partnerja më e rëndësishme e Kosovës dhe se mbështetja e saj është jetike.

Marrëdhëniet me Serbinë

I pyetur për ngecjet në dialogun e nivelit të lartë në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizim të marrëdhënieve,

Kurti ka thënë që kur s’ka dialog mes dy vendeve, jeta nuk pushon në Kosovë. “Unë angazhohem aktivisht për normalizimin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë por, kur ka pauza në këtë proces, jo për fajin tim, atëherë unë merrem me normalizim të shtetit të Kosovës”, ka thënë Kurti për dialogun e lehtësuar nga Bashkimi Evropian në Bruksel.

Ai nuk është takuar me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiqi prej sulmit në Banjskë të Zveçanit në shtator të vitit 2023.

Kurti e kërkon dorëzimin e Millan Radoičiqit nga autoritetet serbe, i cili e ka marrë përgjegjësinë për orkestrim të sulmit në Banjskë. Autoritetet e Kosovës kanë ngritur aktakuzë ndaj tij.

Radoičiq ka qenë nënkryetar i Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë - në kohën e kryerjes së sulmit dhe tani besohet se strehohet në Serbi. Përveç kësaj, Kurti ka përsëritur në intervistën e 11 dhjetorit se kërkon edhe tërheqjen e një letre të ish-kryeministres serbe, Ana Bernabiq, përmes së cilës ajo pati shprehur rezerva për Marrëveshjen për rrugën drejt normalizimit të raporteve me Kosovën dhe për Aneksin e zbatimit të saj.

Kosova dhe Serbia patën arritur pajtueshmëri për këtë marrëveshje në shkurt të vitit 2023. Disa zyrtarë të BE-së kanë thënë se Serbia e ka tërhequr letrën, por deklarata kundërtëse në këtë drejtim ka pasur disa herë.

Dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë zhvillohet prej vitit 2011. Palët kanë arritur disa marrëveshje, por jo të gjitha janë zbatuar. Përparimi në këtë proces është kyç për aspiratat e dy vendeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Ali Ahmeti përkrah protestën e OVLUÇK-së në Shkup, bën thirrje për pjesëmarrje

SHKUP, 12 DHJETOR - Kryetari i Bashkimit Demokratik për Integrit, Ali Ahmeti, ka deklaruar të premten se është në mbështetje të protestës së thirrur nga OVLUÇK në përkrahje të ish-kryerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në qytetin e Shkupit. Në “Facebook”, Ahmeti ka bërë thirrje për pjesëmarrje masive në tubimin që do të mbahet më 13 dhjetor, në orën 13:00, në

Sheshin “Skënderbeu” në Shkup.

Ai ka theksuar se protesta synon kërkesën për drejtësi dhe hedhjen poshtë të akuzave të fabrikuara nga Serbia dhe Rusia, duke shtuar se pjesëmarrja është një akt përgjegjësie për nderimin e sakrificës dhe mbrojtjen e së vërtetës historike. “Nesër, më 13 dhjetor, në orën 13:00, në Sheshin ‘Skënderbeu’ në Shkup, bashkohemi për një

qëllim të qartë: kërkesën për drejtësi dhe hedhjen poshtë të akuzave të fabrikuara të Serbisë dhe Rusisë. Ne dalim me përgjegjësi për ta nderuar sakrificën dhe për ta mbrojtur të vërtetën e historisë sonë. Liria ka emër, UÇK. Dhe ky emër mbetet pjesë e identitetit dhe dinjitetit tonë kombëtar. Ju ftoj të gjithëve që nesër të jemi bashkë!”, ka shkruar Ahmeti.



Punëtorët e KEK-ut protestojnë për rritje pagash

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Punëtorët e KEK-ut kanë protestuar të premten para zyrave të kësaj korporate, duke kërkuar rritjen e pagave, nivelizimin e pagave të sigurimit fizik si dhe zbatimin e pagës së 13. Me pankarta në duar ata kanë përzgjedhur një formë të protestës paqësore. “Punëtorët e rrezikuar në punë, por rrezikshmëria nuk paguhet”, “Duam ngritjen e pagave, dhe ne duam jetën”, “menaxhimet respekto ligjin e punës, paguaj vikendet për punëtorët me ndërrime”, ishin disa nga thirrjet

e tyre në pankarta. Kryetari i Sindikatës së Re KEK, Nexhat Lumnica, në emër të punëtorëve ka kërkuar edhe pagën e 13 për të cilën tha se askush më shumë se ata nuk e meritojnë, duke theksuar se ata janë drita e Kosovës dhe zhvillimit ekonomik të këtij vendi. Ai madje ka thënë se po luhet me ndjenjën e punëtorëve. “Kush më shumë sesa na e meriton pagën e 13. Derisa kërkesa për rritje të pagës është e kamotshme, paga nuk është rritur. Ne sot jemi këtu duke dëgjuar pretime për

gjithë sektorin publik që paguhet nga taksapaguesit e Kosovës nga djersa jonë, që e marrin pagën e 13, e mos t’ia japësh punëtorit të KEK-ut pagën e 13 është më shumë se e turpshme. Sot e shprehim pakënaqësinë në këtë formë, por kaq të qetë nuk do të jemi herëve të tjera. Tekefundit, kompania nuk është e këtyre këtu, por e punëtorëve të KEK-ut dhe gjithë Kosovës. Derisa ne jemi drita e Kosovës dhe jemi aseti kryesor i Kosovës, pa ne nuk ka zhvillim ekonomik”, ka thënë Lumnica.



RRITEN ANKESAT NË OSHP

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Iniciativa për Progres (INPO) ka publikuar raportin “Pavarësia dhe efektiviteti i OShP-së: ndërmjet zbatimit të ligjit dhe luftës kundër korrupsionit” në kuadër të Javës Kundër Korrupsionit 2025. Albulena Nrecaj, drejtoreshë ekzekutive në Iniciativa për Progres (INPO), ka thënë se INPO ka përgatitur raport me synimin që t’i njoftojë edhe politikanët apo zyrtarët publikë për gjetjet e OShP-së, por, sipas saj, ata nuk e kanë parë të udhës të bashkohen në diskutim. Nga analiza e bërë rezultoi se ka rritje të ankesave që janë ankumuar në OShP, por rritje nuk ka edhe sa iu përket ekspertëve shqyrtues në këtë institucion që punon me gjashtë ekspertë të brendshëm dhe dhjetë të jashtëm. Që rrjedhimisht nga analiza e INPO-së nga mbi 1 mijë ankesa, një ekspertit i duhen afërsisht dhjetë ditë kohë për ta trajtuar një ankesë. “Në këtë tryezë do të diskutojmë për një nga shtyllat më të rëndësishme të integritetit të prokurimit publik, do të diskutojmë për Organin Shqyrtues të



Prokurimit, funksionimi i secilit nuk është vetëm teknik, por është një mekanizëm që garanton barazi, konkurrencë dhe ligjshmëri në çdo tender publik. Kur kjo nuk funksionon atëherë nuk përfiton shteti, nuk përfitojnë operatorët ekonomikë, nuk ruhet paraja publike, dhe gjithsesi nuk përfitojnë qytetarët. Qëllimi i raportit nuk është të japë një listë statistikash, apo të flasë në aspektin statistikor ku ka qenë e ku është sot OShP, e sidomos në një vit si ky që kemi pasur

probleme në akses për shkak të ndryshimeve dhe intervenimeve në faqet shtetërore, por ky raport synon t’i paraqesë problemet endemike që ballafaqohet OShP-ja tash e sa vite”, ka thënë Nrecaj. Arbër Kabashi, hulumtues në Iniciativa për Progres (INPO), ka treguar se brenda këtij viti, deri më 11 dhjetor, në OShP janë adresuar 1 164 ankesa. “Kohëzgjatja apo performanca e OShP-së në trajtimin e ankesave është vetëm

simptomë, ngase performanca e drejtpërdrejtë varet nga disa faktorë të tjerë që i kemi identifikuar. Në aspektin numerik deri më 11 dhjetor të këtij viti pranë këtij institucioni janë deponuar 1 164 ankesa, pra shikuar ndër vite numri i ankesave që po deponohen po shkon duke u rritur”, ka thënë ai. Kabashi ka treguar se cilat janë problemet kyçe që po dalin të jenë pengesë e trajtimit të këtyre ankesave. “Problem kryesor rezultoi se operatorët

ekonomikë janë cilësia e dobët e dosjeve të tenderit, problemi me specifikacionet e ndryshme dhe problemet sa i përket vlerësimit dhe ekzaminimit të ofertave. Tjetër problematikë që është shfaqur rezultoi të jetë kapacitetet e pamjaftueshme sa iu përket ekspertëve shqyrtues. Aktualisht OShP-ja ka 6 ekspertë të brendshëm dhe 10 të jashtëm. Në bazë të analizës, duke pasur parasysh numrin e ankesave në OShP, rezultoi se nga 1 219 lëndë, një ekspert, për ta zgjidhur një ankesë, i duhen 10 ditë duke pasur parasysh numrin e lëndëve. Ne me 16 ekspertë e shohim të pamundur për të pasur një efikasitet të lartë nga OShP-ja, sepse numri i ankesave është i madh, kurse numri i ekspertëve është i vogël”, ka shpjeguar Kabashi. Isa Hasani, ushtrues i detyrës së kryetarit të bordit në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), ka thënë se ka një problematikë të pjesa ligjore, duke treguar një rast kur përfaqësues të Bankës Botërore kanë thënë se nuk mund ta mbështesin këtë institucion derisa të ketë një reformë ligjore.

Imri Demelezi emërohet ministër në detyrë i Bujqësisë

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Imri Demelezi është emëruar ministër në detyrë i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural të Kosovës, bëri me dije Qeveria e Kosovës. Ai në këtë detyrë zëvendëson Faton Pecin, i cili do ta marrë detyrën e kryetarit të komunës së Mitrovicës së Jugut. Detyrën ia ka dorëzuar vetë Peci, të cilin Demelezi e ka falënderuar për “punën, angazhimin dhe rezultatet e arritura”. Demelezi nga Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit në detyrë, Albin Kurti, deri më tani mbante pozitën e zëvendësministrit të Bujqësisë. “Marrja e pozitës si ushtrues

detyre i ministrit është një përgjegjësi e madhe, të cilin do ta kryej me përkushtim edhe më të madh. Njohja e punës nga brenda dhe përgatitja profesionale gjatë gjithë jetës vetëm në sektorin e bujqësisë nga pozita të ndryshme, më jep sigurinë se së bashku me ekipin, stafin ministrorë dhe aktorët tjerë brenda dhe jashtë vendit do të arrijmë rezultate konkrete që prekin jetën e secilit prej jush”, shkroi ai në “Facebook”. Peci fitoi garën për Mitrovicën e Jugut në raundin e balotazhit të mbajtur më 9 nëntor, kur u përball me kandidatin e Partisë Demokratike të Kosovës, Arian

Tahiri. Që pas zgjedhjeve të rregullta parlamentare të 9 shkurtit, qeveria në detyrë e Kosovës ka pësuar disa ndryshime, pasi Albulena Haxhiu u largua nga drejtimi i Ministrisë së Drejtësisë pasi u zgjodh nënkryetare e Kuvendit, sikurse edhe Emilja Rexhepi, që u largua nga pozita e zëvendëskryeministres, pasi u zgjodh nënkryetare Kuvendi. Liburn Aliu, ndërkaq, dha dorëheqje nga pozita e ministrit të Infrastrukturës, e në vend të tij u emërua Hysen Durmishi. Kurti, po ashtu, ka liruar nga detyra zëvendësministritin e Zhvillimit Rajonal, Elldin Uglari.



Pas muajsh bllokadë politike, në fund të gushtit deputetët konstituuan përbërjen e re parlamentare, duke i hapur rrugë formimit të ekzekutivit. Megjithatë, dy kandidatë të Lëvizjes Vetëvendosje për pozitën e kryeministrit dështuan që t’i siguronin 61 votat e

nevojshme për zgjedhjen e një ekzekutivi të ri. Pas dështimit për formimin e Qeverisë së Kosovës, presidentja e vendit, Vjosa Osmani, e shpërndau Kuvendin dhe shpalli zgjedhjet e parakohshme parlamentare, të cilat do të mbahen më 28 dhjetor.

TRUMP I ZEMËRUAR, ZELENSKY NË QOSHE: DONBASI NDEZ PËRPLASJEN MES ALEATËVE



**Uashingtoni kërkon
tërheqje. Kievi: do të
vendosë një referendum.
Moska: “Është një gisht i
mesit drejtuar Trump-it”.**

Zëdhënësja e Shtëpisë së Bardhë ka deklaruar se Donald Trump është “jashtëzakonisht i frustruar” si me Rusinë ashtu edhe me Ukrainën: “Nuk dëshiron më bisedime të pafundme, por veprime reale drejt paqes”. Tensionet rriten për shkak të mungesës së një armëpushimi mes Moskës dhe Kievit, pas një tjetër dite përplasjesh dhe propozimesh të refuzuara.

Volodymyr Zelensky, duke folur me gazetarët në Kiev, konfirmoi se negociatat e paqes janë bllokuar kryesisht për shkak të fatit të Donbasit, në veçanti të rajonit të Donetsk-ut. Shtetet e

Bashkuara do të dëshironin që forcat ukrainase të tërhiqeshin dhe që ky territor i shkatërruar të shndërrohej në një “zonë të lirë ekonomike”. Por Moskës nuk i kërkohet e njëjta gjë në pjesën që ajo kontrollon aktualisht. Një pabarazi potencialisht fatale.

Zelensky ndodhet nën presion të jashtëzakonshëm nga SHBA-të dhe, për çështjen territoriale, i referohet kutive të votimit: “Do të jetë populli ai që do të vendosë, përmes zgjedhjeve ose një referendum”. Propozimi i konsultimit popullor është cilësuar nga Moska si “një gisht i mesit drejtuar Shtëpisë së

Bardhë”, përmes zëvendëskryetarit të Këshillit të Sigurimit rus, Dmitri Medvedev, duke ndezur edhe më tej zemërimin e presidentit Trump.

Përshpejtimi i zhvillimeve është gjithnjë e më i dukshëm dhe në 24 orët e fundit kanë dalë në dritë shumë detaje. Kancelari gjerman Friedrich Merz, në një konferencë për shtyp në Berlin me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, sqaroi se kur kishte folur në telefon me presidentin amerikan, së bashku me homologët e tij nga Parisi dhe Londra, Shtëpia e Bardhë nuk e kishte ende versionin e fundit të planit, i cili pasqyron qëndrimin euro-ukrainas. Në të përfshihet një hipotezë për “lëshime territoriale” që Ukraina “mund t’i pranojë”.

Tani, tha Merz, negociatat sipas vizionit europian, do të vazhdojnë në ditët në vijim dhe gjatë fundjavës, dhe më pas mund të ketë “një takim” në fillim të javës së ardhshme


në Berlin, një ftesë që ishte bërë publike vetë nga Trump. “Pjesëmarrja e administratës amerikane do të varet kryesisht nga dokumentet mbi të cilat do të punojmë gjatë kësaj periudhe”, shtoi Merz. Megjithatë, Trumpi, sipas Shtëpisë së Bardhë, mbetet i irrituar si me Moskën ashtu edhe me Kievin: “Nuk do më fjalë boshe, por veprime. Është lodhur nga takimet vetëm për hir të takimeve”.

Një tjetër nyje kritike, sipas Zelenskyt, është fati i centralit bërthamor të Zaporizhzhias, më i madhi në Europë dhe vendimtar për zhvillimin ekonomik të Ukrainës. Aspekti ekonomik do të trajtohet në një dokument të veçantë, për të cilin Zelensky ka folur së fundmi me sekretarin amerikan të Thesarit, Scott Bessent, ashtu si edhe garancitë e sigurisë.

Në këtë kuadër, Zelensky u lidh mbrëmjen e djeshme me një delegacion të gjerë që përfshinte Marco Rubio-n,

Pete Hegseth-in, Steve Witkoff-in, Jared Kushner-in, komandantin suprem të NATO-s dhe forcave amerikane në Europë, gjeneralin Grynkeuich, si dhe vetë Mark Rutte-n. Palët ranë dakord që ekipet të punojnë në mënyrë aktive për të siguruar që në një të ardhme të afërt të ketë “një kuptim të qartë” mbi këto garanci.

Ish-kryeministri holandez theksoi sërish se “siguria e Ukrainës është siguria jonë” dhe se “ne jemi objektivi i radhës i Rusisë; nuk mund të lejojmë të përçahemi”. Ndërkohë, hipoteza se ekziston një version i rezervuar i strategjisë së sigurisë kombëtare amerikane, që parashikon një format të ri jashtë-europian, C5 (SHBA, Rusi, Kinë, Indi dhe Japoni), si dhe ideja për të “shkëputur” Italinë, Austrinë, Poloninë dhe Hungarinë nga BE-ja, ka mbërritur në Bruksel si një tjetër dush i ftohtë. / bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Dinamo e Kievit kërkon transferimin e Muharrem Jasharit

KIEV, 12 DHJETOR - Skuadra e Dinamos së Kievit është gati të përforcohet gjatë merkatos së janarit, me objektivin për t'u kthyer përsëri dominuese në futbollin ukrainas. Dhe për ta bërë këtë, ka piketuar një

futbollist shqiptar. Mediet ukrainase kanë raportuar se gjigantët e futbollit në këtë vend kanë hedhur sytë nga mesfushori i përfaqësueses së Kosovës, Muharrem Jashari. Futbollisti i cili është transferuar

në kampionatin ukrainas nga radhët e Dritës, po shkëlqen me ekipin e tij të tanishëm dhe ka bindur drejtuesit e klubit të qytetit të Kievit që të investojë për t'i siguruar shërbimet e tij. Në sezonin aktual, Jashari ka

luajtur në 15 ndeshje duke shënuar 2 gola e dhënë 6 asistimee, teksa te Dinamo e shohin si një futbollist që mund të bëjë shumë më mirë me klubin e njohur i cili regjistron 17 tituj kampion në Ukrainë.



FFK-ja I BASHKOHET INICIATIVËS “FOOTBALL FOR THE GOALS” TË OKB-së

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) zyrtarisht i është bashkuar iniciativës “Football for the Goals” të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), një platformë globale që e përdor fuqinë e futbollit për ta promovuar zhvillimin e qëndrueshëm, barazinë, të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e

mjedisit. Ky është një hap që na jep mundësi të reja për bashkëpunim dhe projekte që ndikojnë pozitivisht te komuniteti ynë, duke e kthyer futbollin në një mjet real për ndryshim shoqëror. Me aderimin në këtë iniciativë, FFK-ja merr përsipër të promovojë parime kyçe si barazia gjinore, respektimi i të

drejtave të njeriut, përfshirja sociale dhe mbrojtja e mjedisit. Përmes projekteve konkrete, fushatave dhe aktiviteteve komunitare, futbollit pritet të shndërrohet në një platformë edukimi dhe ndërgjegjësimi, ku vlerat shoqërore të kultivohen paralelisht me zhvillimin sportiv. Ky hap i ri krijon mundësi të

gjera bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare, institucione vendore dhe partnerë të tjerë të rëndësishëm. Ai, gjithashtu, e vendos Kosovën në mesin e vendeve që e shohin sportin si motor i përparimit shoqëror, duke e forcuar rolin e futbollit si urë lidhëse mes komuniteteve dhe si mjet transformues për brezat e rinj.



DRITA PËSON HUMBJEN E PARË NË UEFA CONFERENCE LEAGUE

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Kampionia e Kosovës, FC Drita, ka pësuar humbjen e parë në fazën e ligës në UEFA Conference League. Në ndeshjen e zhvilluar të enjten mbrëma, në stadiumin “Fadil Vokrri” në Prishtinë, skuadra e drejtuar nga Zekirija Ramadani është mposhtur me rezultat 3:0 nga klubi i njohur holandez, AZ Alkmaar, në kuadër të xhiros së

pestë të këtij kompeticioni evropian. Drita e ka nisur ndeshjen në mënyrë premtuese dhe është shfaqur e rrezikshme që në minutat e para. Në aksionin e minutës së tretë, Almir Ajzeraj ka gjuajtur fort nga brenda zonës, por portieri mysafir ka intervenuar me vështirësi duke shmangur golin. Megjithatë, ishin holandezët që kanë arritur



të kalonin në epërsi në minutën e 17, kur kapiteni Sven Mijmans ka gjetur rrjetën me një goditje

precize nga zona. Në pjesën e dytë AZ Alkmaar ka shtuar presionin dhe ka realizuar edhe dy gola. Isak Jensen ka shënuar në minutën e 58 për 2:0 pas një kundërsulmi të shpejtë, ndërsa Ibrahim Sadiq ka vulosur fitoren e mysafirëve me golin e tretë në minutën e 90 me gjuajtje me kokë. Pavarësisht prej humbjes, Drita vazhdon ta mbajë një bilanc

pozitiv në këtë fazë të garave, me dy fitore, dy barazime dhe një humbje, duke grumbulluar tetë pikë. Në anën tjetër, AZ Alkmaar është ngjitur në vendin e 11 me nëntë pikë. Ndeshjen e radhës në UEFA Conference League, Drita do ta zhvillojë më 18 dhjetor kundër skuadrës spanjolle Rayo Vallecano, në Madrid, me fillim nga ora 21:00.

BALLKANI - PRISHTINA DHE DRITA - GJILANI, SUPERSFIDAT E FUNDJAVËS NË FUTBOLL

PRISHTINË, 12 DHJETOR - Ballkani dhe Prishtina përballen në njërin prej derbive të xhiros së 17 të Superligës së Kosovës në futboll. Ndeshja do të zhvillohet nesër (e diel) nga ora 13:00 në stadiumin e qytetit në Suharekë. Bëhet fjalë për dy skuadrat e para në tabelë. Ballkani është lider me 29 pikë. Prishtina i ka 27 në vendin e dytë, ndërsa e ka një ndeshje më pak të luajtur. 27 pikë i ka edhe Dukagjini në vendin e tretë.

Ndeshja në Suharekë pritet të jetë e fortë dhe interesante. Të dyja skuadrat synojnë ta shfaqin cilësinë që besojnë se do t'i



dërgojë te titulli i kampionit. Këto dy skuadra u përballën në kuadër të xhiros së tetë. Prishtina kishte fituar 1:0 si

vendase më 4 tetor, por shumë gjëra kanë ndryshuar prej atëherë. Ndër të tjera, edhe trajnerët.

Derbi tjetër i xhiros së 17 është ai në mes të Dritës dhe Gjilanit. Pra është derbi i qytetit të Gjilanit, që zhvillohet të dielën nga ora 13:00 në stadiumin me bari sintetik. Rivaliteti, megjithatë, nuk do të mungojë. Drita do të mundohet të reagojë pas humbjes nga AZ Alkmaari në Ligën e Konferencës, ndërkohë Gjilanin synon fitore për hap tjetër drejt pjesës së epërme të tabelës. Drita është e pesta në tabelë me 24 pikë, por ka një ndeshje më pak të luajtur, atë me Prishtinën. Gjilani është i gjashti me 22 pikë. Të dielën është edhe ndeshja

mes Llapit e Malishevës. Llapi renditet i shtati me 20 pikë, kurse Malisheva mban vendin e katërt me 25 pikë. Xhiroja e 17 hapet sot (e shtunë), kur janë dy ndeshjet e para. Në Lipjan, Prishtinën e Re e pret punë e vështirë me Dukagjinin e Klinës. Ndërkohë në Skenderaj, Drenica e pret Ferizajn. Te Drenica do të debutojë trajneri kroato-german Thomas Brdariq, që u paraqit të martën. Drenica ka 17 pikë dhe është në vendin e tetë, ndërsa Ferizaj është i nënti me 16. Prishtina e Re renditet e fundit me 14 pikë.

Joao Neves thyen rekordin e Cristiano Ronaldos në Ligën e Kampionëve

PARIS, 12 DHJETOR - Me paraqitjen e tij kundër Athletic Bilbaos në barazimin 0-0 të PSG-së, Joao Neves, ka barazuar rekordin e Cristiano Ronaldos

në Ligën e Kampionëve. Neves po vazhdon të shkruajë histori me emrin e tij, duke befasuar të gjithë me nivelin e treguar edhe pse në moshë të re. Sipas

informacionit të raportuar nga “BeFootball”, mesfushori portugez ka luajtur ndeshjen e tij të 30 në këtë garë. Duke arritur këtë total në moshën 21


vjeç e 74 ditë, Neves ka tejkaluar Cristiano Ronaldon, i cili ka luajtur ndeshjen e tij të 30 në Ligën e Kampionëve në moshën 21 vjeç e 226 ditë.






Gjei PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi



Gjei Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](#)

Albrapa Teatr it, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “KASTRIOTI” OP, Carralevë, Komuna e Shtimes, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në vendburim Shushubrad në Carralevë, Komuna e Shtimes.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.02.2026 në ora 11:00 në SHFMU "Abdullah Shabani", Rr Milaim Beha pn, Carralevë, Shtime, do të organizohet debat publik nga Kompania "KASTRIOTI" OP, Carralevë, Komuna e Shtimes, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/5289487423?pwd=atEPUrNDxCwMcX5GSCHJS7NmAu7JDN.1>

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “KASTRIOTI” OP, Carralevë, Komuna e Shtimes, për Pëlqim Mjedisor, për thërrmimin dhe seperimin e gurit gëlqeror në vendburim Shushubrad në Carralevë, Komuna e Shtimes.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin.

ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

-“Concierge Park” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. Unik Identifikues: 811921320.

- Blerta Hoxha shpall te pavlefshme diplomën e SH.M.L.M. "Dr. Xheladin Deda".

- Shkombim Çoçaj shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Zenun Çoçaj "ne Gjonaj.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Duishi" Gjakovë.

- Faton Kajtazi B.I D.P.H. Restorant
shpall te pavlefshëm arkën fiskale GK
05502763 numri fiskal 810551714.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Meriton Deda shpall të palefshme certifikatën e biznesit Lounge Bar “Le Corbusier” Sh.P.K. me nr. 8101275.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 049/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Besim Veseli shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme të lartë të mjekësisë “Dr. Xheladin Deda”.

- Zenun Bajrami B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me numër Unik Identifikues: 810349812.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Kamer Hajdari shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Fazli Greicevci”.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Ajetullah Xhemajli shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Kuvendi i Drenicës" Abri e Poshtme Skenderaj.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajazitit, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Ylbr Peci shpall te pavlefshme dëftesën e shkollës fillore "Fazli Greicevci".



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L



Shoqëria Humanitare Charitable e Kosovës "Mëte Teresa"
The Kosovo Humanitarian and Charitable Society "Mother Teresa"
Humanitarna Dobrotvorna Udruženje Kosovo "Majka Teresa"

UDRUGA "Majka Teresa" KOSOVO
UDRUGA "Mother Teresa" KOSOVO
UDRUGA "Majka Teresa" KOSOVO

CONTRACT AWARD NOTICE SERVICES

According to Article 41 of Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the Law No. 04/L-237, Law No. 05/L-068 and Law No. 05/L-092

Date of the preparation of the Notice: 12/12/2025

Procurement No	Training	001	2025	221
----------------	----------	-----	------	-----

This notice has been prepared in the LANGUAGE(S):

English ☒

SECTION I: CONTRACTING AUTHORITY

I.1) NAME AND ADDRESS OF THE CONTRACTING AUTHORITY (CA)

Official name: Kosovo Humanitarian Charitable Society "Mother Teresa"		
Postal address: str. Mujë Krasniqi n.n. Ulpiana UI/1		
Town: Prishtinë	Postal code: 10000	Country: Kosovo
Contact point(s): Zef Shala	Telephone: 044-128-277	
Email: zefshala@hotmail.com	Fax: 038-542-865	
Internet address (if applicable):	www.motherteresasociety.org	

SECTION II: OBJECT OF THE CONTRACT

II.1) DESCRIPTION

II.1.1) Contract title attributed by the contracting authority:

Professional training for 343 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo

II.1.2) Type of contract and location of works, place of delivery or of performance

(Choose one category only - works, supplier or services - which corresponds to the main part of the specific object of your contract)

	☒ Services
	Main place of performance
	All Kosovo according to the Request of Contracting Authorities

II.1.4) Short description of the object of the contract

Professional training for 343 Beneficiaries for non majority communities in Kosovo

II.1.5) Common Procurement Vocabulary classification (CPV)

93.000.000.-8

II.1.6) Division into lots

NO ☒

II.1.7) Contract value: 24,990.00 Euro

SECTION III: PROCEDURE

III.1) TYPE OF PROCEDURE

☐ Open

III.2) AWARD CRITERIA

☐ Lowest Price

III.3) ADMINISTRATIVE INFORMATION

SECTION IV: AWARD OF CONTRACT

(In case of some parts given to some successful economic operators, repeat § IV.4 and IV.5 for each lot)

IV.1) Date of contract award 12/12/2025		
IV.2) Intended date of contract signing 22/12/2025		
IV.3) Number of received tenders 3		
IV.4) Name and addresses of economic operator to whom the contract has been awarded		
Official name: "D&D Business Support Centre " L.L.C. Prishtinë		
Postal address: 10000 Prishtinë		
Town: Prishtinë	Postal code: 10000	Country: Kosovo
URL (if applicable):		
Contact point(s): Safet Fazlin	Email: info@d&d-bac.com	
Telephone:	Fax:	

IV.5) Information on value of contract

Total final value of contract 24,990.00 Euro
Responsive tender with lowest price: 24,990.00 Euro
Responsive tender with highest price: 27,440.00 Euro

IV.6) The contract is likely to be subcontracted

No ☐

SECTION V: COMPLEMENTARY INFORMATION

V.1) COMPLAINTS

Any interested party may file a complaint with the Contracting Authority according to article 108/A of the Law No. 04/L-042 on Public Procurement of the Republic of Kosovo, amended and supplemented with the Law No. 04/L-237, Law No. 05/L-068 and Law No. 05/L-092, at the address specified in Section I of this Contract award notice.



KOMPANIA REGIONALE E MBETURINAVE "UNITETI" SH.A MITROVICË

Duke u bazuar në nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Përmes (Ligji Nr.03/L-212) dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ MFP/NT-NR 01/2024, Vendlimit të U.D. Kryeshefit Ekzekutiv të datës 10.12.2025 për shpalljen e konkursit, gjatë momentale dhe nevojave të Kompanisë për plotësimin e vendit të punës për përvetësimin e shërbimeve të shërbimeve, K.R.M. "Uniteti" Sh.A, vendosi që më datë 12.12.2025 të shpall:

KONKURS PUBLIK

Automekanikë- Njësia në Shkallëzgjatje, me kohë të caktuar (me kohëzgjatje 1/hjës vjeçare), me mundësi vazhdimi.

Mund i referencës: 12-10-467

Përgatitja profesionale: Diploma e Shkollës së Mesme Automekanik

Lartësia e pagës mujore: 450.00 € Bruto

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Punon në servisimin dhe riparimin e të gjitha llojeve të automjeteve.
- Teston dhe kontrollon rregullisht për mbajtje në gjatësi të rregullt punë të automjeteve,
- Teston dhe provon rregullisht e punës së motorit, valvës, boshtit rrotullues, alternatorit, frejt, përçuesit, lyerjen e motorit, pastroimin e filterave.
- Kryen edhe punë tjera të kësaj natyre sipas nevojës së eprorit të drejtëpërdrejtë

Kriteret e përgjithshme dhe procedurat e vlerësimit:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë të interesuarit të cilët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit. Të punësuarit punësohen për punë me orë të plotë të punës, i cili është 40 orë në javë, me kontratë punë (gjatësi 6) muajt e parë do të jetë në punë provuese në kohë të caktuar dhe vlerësimi nga performanca e të punësuarve dhe nevojave të kompanisë do të vazhdojë apo përthihet kontrata e punës. Procesi i vlerësimit përbëhet nga dy faza: verifikimi paraprak nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e parapara sipas konkursit dhe në bazë të vlerësimit të testimit me shkallë dhe intervistës me gojë. Kandidatët fitues do të shpallen kandidatët me më së shumti pikë të grumbulluara nga procesi i vlerësimit. Kalendar i përfundim të procedurës së rekrutimit mund të zgjas apo të jetë më i shkurt, vlerësimi nga ajo se a është pamundur ankesë apo jo. Në të gjitha rastet kur pamundur ankesë në çdo fazë të procedurës së rekrutimit, ankesa do të ketë efekt suspensiv, dështim e njëjta të shpallëhet nga Komisioni i Ankësve.

Aplikacionet i duhet bashkëngjitur:

- Formulari për aplikim i KRM "Uniteti" Sh.A-Mitrovicë
- Dëshmitë për kualifikimin shkollor (e shkolluar),
- Kopja e letërrefutimit,
- Çertifikatë mjekësore (në rastin e lëndës së kontratës),
- Kopja e çertifikatës/ekstatit të lindjes.
- Dëshmi nga gjykata se nuk jeni i dënuar (në rast se 6 muajt).

Afati dhe mënyra e Aplikimit:

Konkursi mbetet i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e publikimit të të njëjtit në gazeta ditore, dhe atë nga data 13.12.2025 deri më 27.12.2025, ora 16:00.

Kandidatët e interesuar, formularin për aplikim mund ta marrin në zyrën e Aktivës të K.R.M. "Uniteti" Sh.A në qytetin e Mitrovicës, në rr. "Vëllëzët Dragaj" p.n, që ditë punë nga ora 08:00 deri në ora 16:00. Dorëzimi i aplikacionit me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë shpallje publike duhet të bëhet vetëm me anë të adresës elektronike si në vijim: krmuniteti@eshqeo.com Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraprirë nuk pranojnë.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, "Frutex" Sh.p.k., Novak, Komuna Prizren, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për Objektin afarist për grumbullimin, përpunimin dhe prodhimin e pures, lëngjeve dhe pijeve freskuese me bazë frutash, pemësh dhe sirupeve.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 05.02.2026 në ora 10:00 në SHFMU "Zef Lush Marku" fshati Velezhë, Komuna e Prizrenit, do të organizohet debat publik nga "Frutex" Sh.p.k., Novak, Komuna Prizren, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us04web.zoom.us/j/3422360809> ;

passwordi: 617875

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për "Frutex" Sh.p.k., Novak, Komuna Prizren, për Pëlqim Mjedisor, për Objektin afarist për grumbullimin, përpunimin dhe prodhimin e pures, lëngjeve dhe pijeve freskuese me bazë frutash, pemësh dhe sirupeve.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emailin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

vnm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

